


PROTESTANTËT



Kush janë ata?

*Çfarë i dallon Protestantët nga
Ortodoksët dhe Katolikët?*

*Cili është roli i tyre në historinë
e Shqiptarëve?*



Për më shumë informatë:

Qendra Qiriazi
Qendra Tregtare "Mavrovka"
Kati i parë, #34

Ungjilli@live.com

Kisha Ungjillore (Protestante)
Republika e Maqedonisë

Një protestant është një i krishterë i cili i takon një prej disa bashkësive të pavarura. Protestantët, katolikët dhe ortodoksët kanë shumë të përbashkëta në besimin e tyre si të krishterë, por dallohen në disa pika.

Protestantët e vlerësojnë më shumë autoritetin e Shkrimit të Shenjtë dhe të drejtën e çdo personi për ta kuptuar atë vetë. Ortodoksët dhe katolikët i vlerësojnë më shumë traditat e tyre, dhe besojnë se Shkrimi i Shenjtë mund të kuptohet në mënyrë të duhur vetëm nga drejtuesit e tyre. Shumica e dallimeve ndërmjet Protestantëve dhe të krishterëve të tjerë rrjedhin prej këtij dallimi thelbësor të opinionit. Më poshtë janë disa përgjigje specifike për pyetjet që mund të keni në lidhje me veçantitë e besimit Protestant. Por para këtyre pyetje-përgjigjeve do të jetë një histori e shkurtër e Protestantizmit.

Historia i Protestantizmit

Reformacioni ishte një lëvizje për ta rimarrë Ungjillin origjinal, të pastër nga shtresat e traditës që e kishin mbuluar atë. Fjala "protestant" vjen nga fakti se reformatorët e hershëm po i protestonin traditat e Kishës Katolike Romake, që sipas tyre ishin në kundërshtim me Shkrimin e Shenjtë. Një nga reformatorët e parë ishte prifti dhe profesori i teologjisë Jan Husi nga Republika e sotme Çeke. Husi, i cili u bë dëshmor për besimin në 1415, e theksoi rëndësinë e Shkrimeve të Shenjta mbi traditën.

Reformacioni Protestant u përhap në Europën Perëndimore në 1517, kur Martin Luteri, një prift katolik dhe profesor i teologjisë, i bëri thirrje kishës Katolike për t'u reformuar. Luteri tha se kur Bibla është në mospajtim me traditat e kishës, Biblës duhet t'i bindemi. Për shembull kisha e asaj kohe shiste të

(18:4,26,19:8), Tempulli Çifut (Veprat 3:1), dhe shtëpitë private. (Veprat 2:46, 5:42, 18:7; Filemonit 1:2, 18:7; Kolosianëve 4:15; Romakëve 16:5; dhe 1 Korintasve 16:19). Nuk përmendet asnjë herë në Bibël që të Krishterët i mbajtën takimet e tyre në një objekt kishtar.

A përdorin Protestantët të njëjtën Bibël si të krishterët e tjerë?

Biblat e përdorura prej të Krishterëve Protestantë, Ortodoksë dhe Katolikë përmbajnë Tevratin, Zeburin, dhe Ungjillin. I vetmi dallim është se Bibla e përdorur prej Katolikëve dhe Ortodoksëve ka një pjesë shtesë e cila nuk gjendet në Shkrimet Protestante dhe Çifute. Kjo pjesë quhet Apokrifia.

Sipas besimit Protestant si mund të fitojë një njeri jetën e përjetshme në parajsë?

Kur një turmë njerëzish ia bëri Apostullit Pjetër këtë pyetje në Veprat e Apostujve 2:37-38, ai tha: "Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve, dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë." Të pendohesh do të thotë të kthehesh nga rruga e vjetër e jetës mëkatore dhe të vendosësh për të ndjekur Krishtin, duke konfirmuar këtë vendim me anë të pagëzimit dhe duke u përpjekur të jetosh një jetë që i pëlqen Perëndisë.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje, ju lutem na dërgoni një email tek Ungjilli@live.com.


cilat u referohen vëllezërve dhe motrave të Jezusit. (Ungjilli i Mateut 12:46, 13 :55-56, Ungjilli i Markut 3:31, Ungjilli i Gjonit 2:12, 7:3). Protestantët nuk besojnë se Maria ishte e pamëkat, sepse në Ungjillin e Llukës 1:47 ajo e quajti Zot shpëtimtarin e saj, dhe në qoftë se ajo ishte e pamëkat, nuk do të duhet asnjë shpëtimtar.

Pse nuk bënë Protestantët shenjën e kryqit?

Pasi bërja e shenjës së kryqit nuk urdhërohet askund në Shkrimin e Shenjtë, Protestantët nuk e praktikojnë atë.

Si mund të përdorin Protestantët vendet jo të shenjta (si kinemaja ose salla e sportit) për shërbesat e tyre?

Protestantët nuk janë kundër objekteve fetare, por as nuk i shohin ato si të domosdoshme. Jezusi tha në Matt. 18:20, "Sepse kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre." Protestantët besojnë se kjo do të thotë se ajo që e shenjtëron një shërbesë kishtare nuk është vendi apo ndërtesa ku mbahet por, prania e Perëndisë në mes të besimtarëve. Bibla gjithashtu thotë se vetë besimtarët janë tempulli i Zotit, dhe jo ndonjë objekt prej betoni ose prej tullash: "A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?" (1 Korintasve 3:16) Bibla tregon se të krishterët e hershëm u takuan në shumë vende. Këto përfshijnë një shkollë (Veprat 19:9), sinagogat hebraike



Meshari i Gjon Buzukut, 1555, tregon ndikimi i Protestantizmit edhe tek trojet Shqiptare.

drejtën për të shkuar në parajsë me para dhe Luteri e kundërshtoi këtë praktikë fuqishëm. Ai gjithashtu tha, se shpëtimi vjen si dhuratë me anë të besimit në Jezusin dhe jo nga përpjekjet për të bërë vepra të mira.

Në të njëjtën kohë, që Reformacioni Protestant e kaplonte Europën Perëndimore, Ballkani binte nën sundimin Osman. Megjithatë, ndikimi i lëvizjes Protestante u ndje edhe këtu. Vepra letrare më e vjetër shqipe e botuar, që është ruajtur deri sot është “Meshari i Gjon Buzukut”, një libër kishtar i vitit 1555. Meshari përmbante pjesë të shkrimeve të shenjta dhe lutje të ndryshme të krishtera. Në këtë kohë, kjo ishte politika e Kishës Katolike Romake, që Shkrimi i Shenjtë dhe liturgjia duhet të jenë vetëm në gjuhën latine. Megjithatë, këmbëgjulja e Reformatorëve në të drejtën e çdo njeriu për ta kuptuar Biblën vetë rezultoi në përhapjen e përkthimeve të Shkrimit të Shenjtë në gjuhë të ndryshme nëpër Europë. Meshari ishte një prej këtyre.

Protestantizmi më në fund zuri rrënjë tek shqiptarët në kohë që Perandoria Osmane po shpërbëhej në pjesën e fundit të shekullit 19. Në 1864 Shoqëria Biblike Britanike dhe e Huaj (një organizatë Protestante) e angazhoi Kostandin Kristoforidhin, që ta përkthejë Biblën. Në 1866 — më shumë se 3 shekuj pas Mesharit — Besëlidhja e Re (Ungjilli), më në fund u botua në gjuhën shqipe.

Gjerasim Qiriazhi konsiderohet babai i Protestantizmit midis shqiptarëve. Në 1877 ai u largua nga Kisha Ortodokse dhe u bë një anëtar i bashkësisë ungjillore (Protestante) në qytetin e vet, Manastir. Në 1882, pas përfundimit të studimeve teologjike, ai u bë pastor i një bashkësie protestante

Pse nuk përdorin ikona Protestantët?

Protestantët besojnë se Shkrimi i Shenjtë ndalon përdorimin e figurave në adhurim: Në Levitikun 26:1 thuhet: "Nuk do të bëni idhuj, nuk do të ngrini figura të gdhendura ose ndonjë kolonë dhe nuk do të vendosni në vendin tuaj asnjë gur të stolisur me figura, me qëllim që të përuleni para tij; sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj."

Pse Protestantët nuk i luten shenjtorëve ose Marisë?

Protestantët preferojnë t'i ndjekin mësimet e Jezusit në Ungjillin e Mateut 6:9 ku ai na mësoi se si të lutemi: "Ju, pra, lutuni kështu: Ati ynë që je në qiej..." Protestantët besojnë se Bibla ndalon që t'u lutemi personave që kanë vdekur duke i përfshirë edhe besimtarët që janë në qiell. Tek Ligji i Përtërirë 18:10-12 thuhet: "Të mos gjendet midis teje nodnjë...mediume që konsultojnë frymat." Fjala "mediume" do të thotë dikush që komunikon me njerëz të vdekur.

Çfarë besojnë Protestantët për Marinë?

Protestantët besojnë se Maria ishte një shembull i mrekullueshëm i bindjes ndaj Zotit, dhe se ajo ka mbetur e virgjër deri pas lindjes së Jezusit. Kjo bazohet në Ungjillin e Mateut 1:25, ku thotë për Jozefin, i fejuari i Marisë: "Por nuk fjeti me të gjer në lindjen e birit të saj, të cilit ia vuri emrin Jezus," si edhe pjesë të tjera në Bibël të


Jezusi tha se një burim i madh i gabimeve është mosnjohja e Biblës (Mateu: 22:29): "Ju bëni gabim, sepse nuk e kuptoni as Shkrimin as pushtetin e Perëndisë." Tek Veprat e Apostujve 17:11 banorët e qytetit të Bereas lavdërohen, sepse ata e studionin Biblën vetë: "Çifutët në Berejë ishin më të hapur se ata në Selanik. Ata dëgjuan me vëmendje të madhe dhe kontrolluan çdo ditë në Shkrimin e shenjtë për të parë nëse ajo që u thoshte Pali ishte e drejtë." "

Çfarë mendojnë Protestantët për traditat kishtare?

Protestantët nuk janë kundër traditave, përveçse kur ato bien në kundërshtim me Shkrimet e Shenjta. Kjo bazohet kryesisht në komentet e Jezusit tek Marku 7:8: "Duke lënë pas dore, pra, urdhërimin e Perëndisë, ju i përmbaheni traditës së njerëzve," dhe në Ungjillin e Mateut. 15:3: "Dhe ju përse shkëlni urdhërimin e Perëndisë për shkak të traditës suaj?"

Pse Protestantët nuk i pagëzojnë foshnjat e tyre?

Shumë Protestantë besojnë se pagëzimi duhet të jetë shpallje e pendimit (Veprat 2:38) dhe një vendim për ta ndjekur Jezusin. Foshnja nuk ka mëkat për t'u penduar dhe nuk është në gjendje për të marrë një vendim që të ndjekë Jezusin.



Gjerasim Qirazi u bë pastor i një bashkësie protestante në Shkup në 1882.

në Shkup. Në 1884 ai filloi të punonte për Shoqërinë Biblike Britanike dhe të Huaj duke ua shpërndarë shqiptarëve Shkrimin e Shenjtë në gjuhën shqipe. Kjo përputhej shumë me konceptin protestant që çdo njeri duhet të ketë mundësi ta lexojë Fjalën e Perëndisë në gjuhën e tij amtare. Megjithatë, Qirazi u dëshpërua nga fakti, që shumë prej bashkëkom-basve të tij nuk ishin në gjendje të lexojnë Shkrimin

e Shenjtë, edhe sikur ta kishin në shqip, pasi ata ishin analfabetë. Ai u bind se Ungjilli dhe arsimi ishin dy faktorët kyç për emancipimin e popullit të tij. Nga baza e tij në Korçë, ai themeloi kishën ungjillore në 1890 dhe dy vjet më vonë, me ndihmën e motrave hapi shkollën e parë për vajza në gjuhën shqipe. Në të njëjtin vit që u hap shkolla, Gjerasimi themeloi Vëllazërinë Ungjillore Shqiptare, e cila u riaktivizua pas Komunizmit në 1992 në 100 vjetorin e saj.

Pas vdekjes së Gjerasimit në 1894, vëllai i vogël Gjergji, dhe motrat Sevastia dhe Parashqevia, vazhduan punën e tij. Ata ishin ndër iniciatorët kryesorë të Kongresit të Manastirit, i cili u mbajt në shtëpinë e familjes së tyre. Nga delegatët që morën pjesë në Kongresin e Manastirit shtatë ishin Protestantët: Gjergji Qiriaz, Parashqevi Qiriaz, Grigor Cilka, Sami Pojani, Petro Nini Luarasi, Fillomena Bonati, dhe Violet Kennedy.

Reformacioni Protestant sot është përhapur jo vetëm në Shqipëri, por në gjithë botën. Kishat që u formuan nga ky reformacion i përfshijnë Luteranët, Kishën e Reformuar Holandeze, Kishën Anglikane, Baptistët, Pentakostalët dhe të tjerë. (Dëshmitarët e Jehovahit dhe Mormonët nuk konsiderohen si të krishterë nga Katolikët, Ortodoksët dhe Protestantët.) Këtu në Maqedoni Protestantizmi njihet si feja e Boris Trajkovskit. Shumë Protestantë sot quhen "ungjillore", sepse ata besojnë se të krishterët duhet t'i binden urdhërimit të Krishtit: "Shkoni në gjithë botën dhe i predikoni ungjillin ..." (Mateu 28:19).

Pyetje-Përgjigje

Pse Protestantët e kuptojnë Shkrimin e Shenjtë vetë?

Protestantët thonë se çdo i krishterë është përgjegjës për jetën e tij shpirtërore, dhe secili mund ta kuptojë Biblën me ndihmën e Perëndisë. Disa vargje Biblike tregojnë, se vetë Perëndia na mëson, nëqoftëse ne jemi të gatshëm: 1 Gjoni 2:27 thotë: "Por juve Mesia jua dha Shpirtin e tij. Ky Shpirt mbetet në ju dhe për këtë nuk keni nevojë për ndonjë mësues tjetër. Ai vetë ju mëson për gjithçka. Ajo që thotë është e vërtetë dhe asnjë gënjeshtër. Prandaj, zbatoni çfarë ju mëson Shpirti: rrii të lidhur me Mesinë."

Jezusi tha tek Ungjilli i Gjoni 6:45: "Në profetët është shkruar: 'Të gjithë do të jenë të mësuar nga Perëndia.' Çdo njeri, pra, që ka dëgjuar dhe mësuar nga Ati, vjen tek unë." Dhe në 16:13: "Por, kur të vijë Ai, Fryma e së vërtetës, Ai do t'ju prijë në çdo të vërtetë..."

Udhëheqësit e Kishës mund të na ndihmojnë ta kuptojmë Biblën, por ne duhet të jemi të kujdesshëm për disa arsye. Së pari, Bibla tregon për shumë raste kur udhëheqës kishtarë e keqinterpretojnë Shkrimin, si thotë Pjetri tek 2 Pjetrit 2:1 "Por siç u paraqitën profetët e rremë nëpër popullin e Izraelit, ashtu mes jush do të paraqiten mësues të rremë që do të shpallin mësim të rreme. Me anë të sjelljes së tyre, ata do ta tradhtojnë Zotin që i çliroi me çmimin e gjakut të tij. Për këtë arsye, ata do të rrënohen papritur."